

## AKT THEMELIMI I SARAH 2018 SHPK

Sot me date 16/01/2018, une i nenshkuari: Z. **Tedi Shehu**

I biri i Ilirjan, lindur ne Elbasan dhe banues ne Tirane, shpreh vullnetin per hartimin e ketij Akti Themelimi te Shoqerise **SARAH 2018 SHPK** si me poshte vijon:

- 1. FORMA LIGJORE “ SHPK ”**, eshte nje shoqeri tregtare me perjegjesi te kufizuar.
- 2. ORTAK I VETEM THEMELUES** Ortak vetem, themeluesja e shoqerise eshte **Z. Tedi Shehu**
- 3. OBJEKTI** Objekti i veprimitarise te shoqerise **SARAH 2018 SHPK** eshte:

- Transferim te Parave ne emer dhe per llogari te institucionit finanziar Jo Banke AK-INVEST sha
- Kembim Valutor
- Siguracione

### **4. SELIA**

Selia e shoqerise tregtare **SARAH 2018 SHPK** do te jetë ne adresen: Tirane, Njesia Bashkiake nr.2, Rruga Tefta Tashko, Zona kadastrale 8150, Nr pas. 5/41, kati 1

### **5. KOHEZGJATJA**

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj, sipas objektit, per nje periudhe kohore te pacaktuar, e cila fillon nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar. Afati i permendur ne piken 1 te ketij neni mund te shkurtohet apo zgjatet me vendim te Ortakut te vetem te shoqerise, ne perputhje me rregullat e percaktuara nga Statuti i Shoqerise.

### **6. KAPITALI I SHOQERISE**

Kapitali themeltar i shoqerise tregtare **SARAH 2018 SHPK** eshte 1.500.000 Leke (nje milion e peseqind mijte leke). Kapitali themeltar eshte i ndare ne 1 kuote dhe vlera nominale e nje kuote eshte 1.500.000 Leke (nje milion e peseqind mijte lek). Ortaku i vetem eshte zoteruesi i te gjitha kuotave te shoqerise, ne vleren 100% te



tyre. Kuotat jane nominative dhe nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere. Cdo kuote perfaqeson te drejten e nje vote.

## 7. ORTAKU I VETEM

Ortaku i Vetem ushtron kompetencat qe ligji i jep Asamblese se Ortakeve.

## 8. DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Shoqeria drejtohet nga Administratori. Administrator i pare i shoqerise  
**SARAH 2018 SHPK** eshte **Z. Tedi Shehu**

## 9. SHPERBERJA DHE LIKUIDIMI

Shpeberja dhe likuidimi i shoqerise tregtar mund te vije ne cdo kohe dhe per cfardo shkaku ligjor, duke perfshire dhe falimentimin, privimin per te ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe te cdo faktori tjeter qe nuk varet nga vullneti i ortakeve te shoqerise.

**Themeluesi**

**Z. Tedi Shehu**

*Tedi Shehu*

